

PJESËMARRJA QYTETARE NË VENDIMMARRJE PËRMES QEVERISJES
ELEKTRONIKE SI STANDARD I BASHKIMIT EVROPIAN: RASTI I KOSOVËS

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SHKENCËS NË SHKENCA POLITIKE

Nga

Elira Salihu



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI SHKENCA POLITIKE

Korrik, 2026

REZYME

“PJESËMARRJA QYTETARE NË VENDIMMARRJE PËRMES QEVERISJES ELEKTRONIKE SI STANDARD I BASHKIMIT EVROPIAN: RASTI I KOSOVËS”

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Bardhok Bashota

Kandidate: Elira Salihu

Ky punim trajton ndërlidhjen ndërmjet qeverisjes elektronike dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, duke e analizuar qeverisjen elektronike si një ndër standardet kryesore të Bashkimit Evropian për modernizimin e administratës publike, rritjen e transparencës dhe fuqizimin e demokracisë pjesëmarrëse. Studimi shqyrton mënyrën se si Bashkimi Evropian e ka zhvilluar këtë koncept përmes kornizës së tij institucionale dhe ligjore, strategjive, politikave dhe praktikave më të mira të shteteve anëtare, si dhe vlerëson nivelin e përafrimit të Kosovës me këto standarde në kuadër të procesit të integritimit evropian. Në fokus të veçantë të punimit është analiza e rolit të qeverisjes elektronike në nxitjen e pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse, duke identifikuar njëkohësisht faktorët që ndikojnë në funksionimin efektiv të saj. Për këtë arsye, punimi analizon sfidat kryesore me të cilat përballlet Kosova, siç janë ndërveprueshmëria institucionale, infrastruktura digjitale, aftësitë digjitale, qasja e barabartë në shërbime elektronike dhe besimi në përdorimin e platformave digjitale. Krahas identifikimit të këtyre sfidave, studimi paraqet edhe rekomandime konkrete për avancimin e qeverisjes elektronike dhe forcimin e pjesëmarrjes qytetare, në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira të Bashkimit Evropian.

Hulumtimi është realizuar duke përdorur metodën cilësore, përmes analizës së literaturës shkencore, dokumenteve zyrtare të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës, akteve ligjore, dokumenteve strategjike dhe raporteve monitoruese që trajtojnë qeverisjen elektronike dhe pjesëmarrjen qytetare. Për të plotësuar analizën teorike, janë shqyrtuar edhe disa nga platformat digjitale të pjesëmarrjes publike në Kosovë, me qëllim vlerësimin e funksionalitetit të tyre, nivelit të qasjes së qytetarëve dhe kontributit që ato japin në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së publikut në proceset vendimmarrëse.

Pyetjet kërkimore të këtij punimi trajtojnë mënyrën se si Bashkimi Evropian e koncepton dhe promovon qeverisjen elektronike si standard për fuqizimin e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, nivelin e zhvillimit të saj në Kosovë në raport me standardet evropiane, sfidat që

pengojnë zbatimin efektiv të saj, si dhe mundësitë për përshtatjen e praktikave më të mira të Bashkimit Evropian në kontekstin e Kosovës.

Hipotezat

Bazuar në qëllimin e hulumtimit, pyetjet kërkimore dhe analizën e literaturës relevante, janë ngritur hipotezat e mëposhtme, të cilat shërbejnë si bazë për analizën dhe interpretimin e gjetjeve të punimit:

Hipoteza I: “Bashkimi Evropian prioritetizon qeverisjen elektronike edhe tek shtetet candidate të saj”

Hipoteza II: “Qeverisja elektronike zvogëlon hendekun midis qeverisë dhe grupeve të margjinalizuara ose të papërfaqësuara duke ofruar mekanizma më gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për pjesëmarrje”

Hipoteza III: “Iniciativat digjitale ndikojnë pozitivisht në efektivitetin e qeverisjes elektronike në përmirësimin e pjesëmarrjes publike në Kosovë”

Hipoteza IV: “Mungesa e infrastrukturës, aftësitë e kufizuara digjitale dhe shqetësimet për privatësinë e të dhënave, kufizojnë potencialin e plotë të qeverisjes elektronike për të nxitur pjesëmarrjen publike në Kosovë”

Punimi është i organizuar në tre kapituj, përveç hyrjes, përfundimeve, rekomandimeve dhe bibliografisë:

Kapitulli I: Qeverisja elektronike në raport me pjesëmarrjen publike ndahet në dy nënkapituj.

Nënkapitulli i parë trajton konceptin e qeverisjes elektronike si formë inovative e administrimit publik dhe evoluimin e saj, ndërsa nënkapitulli i dytë analizon ndërlidhjen ndërmjet qeverisjes elektronike dhe pjesëmarrjes publike në vendimmarrje, duke trajtuar përfitimet dhe sfidat që lidhen me këtë proces.

Kapitulli II: Qeverisja elektronike në Bashkimin Evropian ndahet në pesë nënkapituj.

Fillimisht trajtohet korniza institucionale e Bashkimit Evropian për qeverisjen elektronike, më pas korniza ligjore, praktikat dhe platformat ekzistuese digjitale, strategjitë e Bashkimit Evropian në raport me qeverisjen elektronike si mjet për nxitjen e pjesëmarrjes publike në shtetet candidate, si dhe në fund analizohet qeverisja elektronike si pjesë e kriterit administrativ të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Kapitulli III: Performanca e Kosovës në qeverisje elektronike: avantazhet dhe sfidat ndahet në katër nënkapituj. Në këtë kapitull analizohet kuadri ligjor dhe institucional i qeverisjes elektronike në Kosovë, iniciativat për rritjen e pjesëmarrjes qytetare përmes qeverisjes elektronike, gjendja praktike e përfshirjes publike në vendimmarrje, si dhe vlerësimi i performancës së Kosovës në këtë fushë nga Bashkimi Evropian.

Në përfundim të punimit paraqiten gjetjet kryesore të hulumtimit, të cilat burojnë nga analiza e literaturës shkencore, dokumenteve zyrtare dhe praktikave të shqyrtuara gjatë studimit. Përmes këtyre gjetjeve vlerësohet niveli i zhvillimit të qeverisjes elektronike në Kosovë në raport me standardet e Bashkimit Evropian, si dhe identifikohen sfidat dhe mundësitë për përmirësim. Mbi këtë bazë, ofrohen rekomandime konkrete që synojnë avancimin e qeverisjes elektronike, rritjen e pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, në funksion të përafrimit të mëtijshëm të Kosovës me standardet dhe praktikatat më të mira të Bashkimit Evropian.